

V E N D I M
Nr. 269, datë 25.5.2000

**PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT, MAGAZINIMIT, PRODHIMIT E TË TRANSFERIMIT
TË MINAVE KUNDËR PERSONIT DHE SHKATËRRIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 122, të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8547, datë 11.11.1999, “Për ratifikimin e Konventës “Për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit e të transferimit të minave kundër personit dhe shkatërrimin e tyre”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet përdorimi i të gjitha llojeve të minave kundër personit (MKP).
2. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet prodhimi i të gjitha tipeve të minave kundër personit nga subjektet shtetërore dhe private.
3. Ndalohet shitja dhe eksportimi i minave kundër personit.
4. Ministria e Mbrojtjes të heqë nga kompletimi i Forcave të Armatosura të gjitha tipet e minave kundër personit, që ka sot në përdorim.
5. Të asgjesohen të gjitha minat kundër personit, që janë në inventar të Forcave të Armatosura, brenda vitit 2004.
6. Lejohet transferimi i minave kundër personit vetëm për efekt të grumbullimit, me qëllim asgjesimi, sipas programit të miratuar.
7. Të përcaktohen dhe të pastrohen të gjitha sipërfaqet e infektuara me mina në territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda vitit 2009.
8. Ministria e Mbrojtjes në mbështetje të pikave 5 dhe 7 të këtij vendimi, të paraqesë në Këshillin e Ministrave, programin dhe efektet financiare të nevojshme për realizimin e këtyre detyrimeve, tre muaj pas hyrjes në fuqi të tij.
9. Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet e tjera shtetërore, nëpërmjet kontakteve zyrtare me qeveritë e shteteve palë ose jo në konventë, me Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat joqeveritare të kërkojë, mbështetje financiare dhe teknologjike për realizimin e projekteve të asgjesimit të minave kundër personit, pastrimin e fushave të minuara, si dhe ndihmë për viktimat e minave.
10. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme, të bashkëpunojnë ndërmjet tyre në drejtimin e informimit të ndërsjellë, për zbatimin e programit, dhe kjo e fundit të raportojë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm, jo më vonë se 30 prilli i çdo viti, për punën që bëhet dhe për problemet që dalin në procesin e zbatimit të programit, sipas përcaktimeve të konventës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta